

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Maj, 2018

Tiranë, më 26 Qershor 2018: Numri i shtetasve shqiptarë dhe të huaj të hyrë në territorin shqiptar, në muajin Maj 2018, është 789.391, krahasuar me Maj 2017, ky tregues rezulton me rritje 9,5 %.


Në Maj 2018, numri i shtetasve të huaj të hyrë në vend është 394.869. Krahasuar me Maj 2017, ky numër është rritur me 9,7 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në pesëmujorin e parë e 2018 është 1.423.367 duke u rritur me 7,7 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2017.

Në Maj 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Gjermania ka patur rritjen më të madhe me 61,5 %, ndërsa uljen më të madhe e kanë patur shtetasit nga Kosova me 8,7 %.

Në pesëmujorin e parë 2018, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Polonia ka patur rritjen më të madhe 34,4 % .

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Shtetasit shqiptarë dhe të huaj të dalë nga vendi, gjatë muajit Maj 2018, janë 839.235 duke shënuar një rritje me 6,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Maj 2018, është 422.149 krahasuar me Maj 2017, ky numër është rritur 3,7 %. Numri i shtetasve të huaj të dalë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Maj 2018, është 417.086. Krahasuar me Maj 2017, ky numër është rritur 9,2%.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në pesëmujorin parë 2018, është 1.985.152, duke u rritur 5,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Maj-17	Maj- 18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Maj 17	Janar- Maj 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje gjithsej	721.054	789.391	9,5	3.002.966	3.277.090	9,1
Shqiptarë	360.972	394.522	9,3	1.681.492	1.853.723	10,2
Të Huaj	360.082	394.869	9,7	1.321.474	1.423.367	7,7
Dalje gjithsej	789.052	839.235	6,4	3.229.447	3.466.047	7,3
Shqiptarë	407.096	422.149	3,7	1.882.335	1.985.152	5,5
Të Huaj	381.956	417.086	9,2	1.347.112	1.480.895	9,9

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Maj -17	Maj -18	Ndryshim vjrtor (%)	Janar- Maj 17	Janar- Maj 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Kosovë	105.645	96.501	-8,7	433.252	443.498	2,4
Maqedoni	48.951	54.903	12,2	193.636	204.957	5,8
Greqi	31.825	38.954	22,4	160.098	171.489	7,1
Itali	22.836	26.080	14,2	98.019	105.503	7,6
Angli	10.473	12.167	16,2	30.798	32.164	4,4
Mali i zi	36.209	40.825	12,7	143.618	150.155	4,6
Poloni	6.657	8.981	34,9	9.424	12.662	34,4
SHBA	8.181	11.172	36,6	23.245	26.667	14,7
Gjermani	11.002	17.768	61,5	27.788	34.724	25,0
Zvicër	3.009	3.375	12,2	11.142	10.636	-4,5
Të tjera	75.294	84.143	11,8	190.454	230.912	21,2
Gjithsej	360.082	394.869	9,7	1.321.474	1.423.367	7,7

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Maj -17	Maj-18	Ndryshimi vjetor (%)	Janar- Maj 17	Janar- Maj 18	Ndryshimi vjetor progresiv (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	360.082	394.869	9,7	1.321.474	1.423.367	7,7
I. Personale	353.277	385.506	9,1	1.296.478	1.391.318	7,3
1. Pushime	132.140	148.291	12,2	366.919	316.630	-13,7
2. Vizitë në miq e të afërm	840	865	3,0	4.254	4.851	14,0
3. Vizitë ditore	2.224	5.823	161,8	26.293	49.845	89,6
4. Trajtim shëndetësor	22	17	-22,7	244	111	-54,5
5. Qëllime fetare	55	87	58,2	239	346	44,8
6. Vizitorë të tjerë	201.905	213.211	5,6	837.918	955.242	14,0
7. Udhëtarë transit	16.091	17.212	7,0	60.611	64.293	6,1
II. Biznes dhe profesionale	6.805	9.363	37,6	24.996	32.049	28,2

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Maj 2017	97.413	49.114	574.527	106.999	49.488	632.565
Maj 2018	110.859	55.807	622.725	110.613	55.251	673.371
Ndryshimi vjetor (%)	13,8	13,6	8,4	3,4	11,6	6,5
Janar-Maj 2017	442.353	160.425	2.400.188	460.550	199.313	2.569.584
Janar-Maj 2018	495.225	152.145	2.629.720	501.686	174.452	2.789.909
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	12,0	-5,2	9,6	8,9	-12,5	8,6

Metodologji

Përkufizime

Vizitorë: Për qëllime të statistikës së turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet në kufi.

Hyrjet është një koncept që i referohet të gjitha arritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet në kufi. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës.

Qëllimi kryesor i vizitës është qëllimi pa të cilën udhëtimi nuk do të kryhej. Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për arsye:

Vizitat për *qëllime personale*

1. Pushime
2. Vizitë në miq e të afërm
3. Vizitë ditore
4. Trajtim shëndetësor
5. Qëllime fetare
6. Vizitorë të tjerë
7. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Policisë së Shtetit).

Të dhënat e muajit të fundit janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>